



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA DIBËR  
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 106 Datë 03/ 10 / 2023


**“ Për dhënien e pëlqimit për lidhjen e kontrates me Shoqërinë “ Greencells Renewables” Albania Shpk për dhënien me qera të ngastrave 253b dhe 253c dhe sipas ASHK në zonën kadastrale nr.2113 lloji i pasurisë Kullotë me nr.pasurie 4/1 dhe në zonën kadastrale nr.3169 lloji i pasurisë Kullotë me nr pasurie 13/36/12 dhe heqjen e tyre nga fondi pyjor/kullosor”.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 “Për rregullat,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhenien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik”, dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet juridike në fushën e dhënies në përdorim të fondit pyjor/kullosor, VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë dhe të ish-komunave”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **03.10.2023** me 20 vota pro, 6 kundër dhe 3 apstenim:

**VENDOSI:**

1. Për dhënien e pëlqimit për lidhjen e kontratës me Shoqërinë “Greencells Renewables” Albania Shpk për dhënien me qera të ngastrave 253b dhe 253c dhe sipas ASHK në zonën kadastrale nr.2113 lloji i pasurisë Kullotë me nr.pasurie 4/1 dhe në zonën kadastrale nr.3169 lloji i pasurisë Kullotë me nr pasurie 13/36/12 dhe heqjen e tyre nga fondi pyjor/kullosor.
2. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave ngarkohet Sektori i Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Dibër.
3. Tarifa e qerasë për ngastrat të caktohet sipas VKM nr.559 datë 29.07.2023 “Për përcaktimin e cmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.
5. Vendimi u shpall me datë **10.10.2023**.

Kryetare e Këshillit Bashkiak  
Irimi Shëhu





3631  
26/09/23  
Mbrojtja e Ot

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA DIBËR  
DREJTORIA E PYJEVE**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Peshkopi, më \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / 2023

**RELACION**

Për dhënien e miratimit në parim kundrejt kontratës së qerasë vjetore të sipërfaqes prej 93 ha të fondit pyjor për ndërtimin e një "Impianti Fotovoltaik".

**Drejtuar :** Komisionit të Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake dhe Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë, Mbikqyrjes Financiare dhe Komisionit të Ekonomisë vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural të Këshillit Bashkiak Dibër.

Drejtoria e pyjeve disponon si pjesë të saj të fondit pyjor sipërfaqe pyjore të përshtatshme për ndërtimin e "Impianteve Fotovoltaik" për ndërtimin e të cilëve ka një interes nga subjekte të ndryshme për marrjen në përdorim kundrejt kontratës së qerasë vjetore. Një prej tyre është ngastra 253/b e ekonomisë pyjore Kastriot - Sllovë prej 93 ha që ndodhet mbi kodrat e Kastriotit, në afërsi të fshatit Rrenxë, Njësia Administrative Kastriot.

Ndërtimi i tyre dhe dhënia në përdorim kundrejt kontratës së qerasë vjetore është me interes jo vetëm të rritjes së të ardhurave të bashkisë duke patur parasysh investimin e konsiderueshëm të tyre, por edhe në aspektin social ekonomik që lidhet me punësimin e banorëve lokal të zonës dhe përmirësimet në infrastrukturorë.

Dhënia e miratimit në parim të kësaj sipërfaqeje u mundëson subjekteve të interesuara të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm për këtë qëllim bazuar në legjislacionin në fuqi, dhe tërkesave të Udhëzimit nr.1 datë 09.06.2016 "Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për heqjen/dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik", prandaj për sa më sipër kërkohet miratimin e kërkesës së paraqitur në këtë relacion.

konceptoi:

Përgjegjësi i Sektorit të Pyjeve dhe Kullotave.

Ing. Vullnet TAFA

DREJTORI

Gani SALKURTI